

Mr. Ali Bardhi

**SHKOLLAT FILLORE PUBLIKE KATËRVJEÇARE (SIBJAN
DHE IBTIDAI MEKTEBET) NË TREVËN E KRAJËS SIPAS
DOKUMENTEVE TË ARKIVIT OSMAN TË SHTETIT –
STAMBOLL
(fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX)**

Përmbledhje

Ky punim objekt studimi ka trajtimin e dokumentimeve të shkollave fillore publike (mektebeve) në trevën e Krajës (fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX) duke iu referuar dokumenteve të Arkivit Osman të Shtetit - Stamboll (BOA) të cilin kemi arritur ta hulumtojmë. Këto dosje na japin të dhëna për shkollat fillore publike (mektebeve), për emërimin e mësimitdhënësve, për dhënien e pagave, për hierarkinë e tyre etj. Njëherësh, kuptojmë se disa shkolla fillore kanë ruajtur emrin e vjetër “Sibjan”, disa të tjera, pas reformës, emrin e ri “Ibtidai”. Duke dashur që njohuritë tona rreth këtyre shkollave të pasurohen edhe më tepër, jemi përpjekur që të japim informacion shtesë edhe nga arkivat e xhamive Skje dhe Muriq të Poshtëm të trevës së Krajës, të mbetura deri më sot, edhe nga ditari personal i punës i inspektorit për arsim në Vilajetin e Shkodrës, Daut Boriçi (1870-1877).

Fjalët kyçe: *Kraja, arsimi, shkolla, mektebi*

Abstract

The work you are having at your disposal deals with a public primary schools (mekteb) in the region of Kraja (end of XIX century and beginning of XX century) while using as a point of reference the archival documents of Ottoman state archive based in Istanbul (BOA) that i have searched.

This dossiers give us an information for the existence of primary public schools (mektebe), the teachers names, salary, and the hierarchy etc. We learn that some primary schools kept the old name "Sibjan" while others the reformed induced name "ibtidai".

As a precursor to get even more knowable about those schools to enrich furthermore our understanding we tried to ad some bonus information from the archives of the mosques in Skje and Muriq Poshtë, all belonging to region of Kraja. Furthermore using the personal diary of the chief inspector for Education in the Vilajet of Shkodra Daut Boriçi (1870-1877)

HYRJE

Kraja është trevë shqiptare e Malësisë së Mbishkodrës në Malin e Zi, që shtrihet në bregun jug-perëndimor të liqenit të Shkodrës deri në Malin e Rumisë, pas të cilit janë dy treva, Ana e Malit dhe Tivari. Aktualisht Kraja është pjesë administrative e komunës së Tivarit.

Në aspektin tipologjik, Kraja ndahet në dy nëntërësi të reja rajonale. Në anën lindore të saj gjendet Bashkësia Lokale e Ostrosit, ose Kraja (në kuptimin e ngushtë), e cila ndryshe quhet Kraja e Madhe dhe përbëhet nga fshatrat: Ftjan, Bobosht, Kështenjë, Martiq, Ostros, Arbnesht dhe Skje. Në anën perëndimore të saj shtrihet Bashkësia Lokale e Shehanit me fshatrat: Krricë, Dedaj, Gurëz, Pinç, Rjeps, Muriq, Bes, Babsul, Ljare dhe Brisk.¹⁸

Historia e vendbanimit të Krajës është mjaft e lashtë dhe përgjatë saj ka pasur plot jetë dhe aktivitet, nga edhe kanë dalë personalitete të njohura si në vend ashtu dhe më gjerë. Ndër dëshmitë kryesore që argumentojnë jetën në një vend, si pjesë e rëndësishme e kulturës materiale dhe shpirtërore, janë edhe shkollat.

Në lidhje me fushën e arsimit studimet janë të mangëta për këtë trevë përpara shek. XIX, prandaj në të ardhmen duhen bërë hulumtime. Kohën e fundit janë bërë disa hulumtime që kanë për objekt shkollat fillore të trevës së Krajës përgjatë shek. XX deri në ditët e sotme nga autorë vendas dhe të tjerë, duke përfshirë edhe shkollat (mektebet) gjatë fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX¹⁹, por nuk kemi ndonjë të tillë me referenca nga dokumentacioni arkivor osman.

Në lidhje me temën në fjalë kemi marrë për referencë pesëmbëdhjetë (15) dosje nga Arkivi Osman i Shtetit - Stamboll, njëmbëdhjetë prej të cilave i përkasin fondit MF.MKT (Maarif Mektubi Kalemî), dy dosje MF.İBT. (Maarif İbtidai Kalemî) dhe dy dosje ML.EEM (Maliye Nezareti). Dy fondet e para janë të ndërlidhura me çështjet arsimore, kurse fondi i fundit ndërlidhet me Ministrinë e Financave. Më poshtë po paraqesim në mënyrë të përmbledhur përmbajtjet e dosjeve që bëjnë fjalë për këto shkolla, kurse në pjesën shtesë janë paraqitur disa faksimile origjinale.

Shkolla fillore (ibtiadi mektebi) në Arbnesht - nahija e Krajës

Rreth ndërtimit të shkollës fillore (ibtidai mektebit) të fshatit Arbnesht ekzistojnë të dhëna të shënuara në vjetarët e Ministrisë së Arsimit. E dhëna

¹⁸ Hajrudin S. Muja, *Kraja (monografi)*, Art Club, Ulqin, 2018, f. 23

¹⁹ Hajrullah Koliqi, *Historiku i arsimit në Krajë*, Prishtinë, 1999; Hamid Alaj, *Zhvillimi i shkollave dhe arsimit në trevën e Krajës dhe Shehanit*, Art Club, Ulqin, 2014; Hajrudin Muja, *Kraja*, Art Club, Ulqin, 2018; Ali Gjeçbritaj, *Shkolla në Krajë (1929-2019)*, 2020

për ndërtimin e saj jepet më 1301/1885.²⁰ Lidhur me shkollën fillore (mektebit) të fshatit Arbnesht kemi identifikuar vetëm një dosje, datë 5, kanuni sani 1312 rumi/17 janar 1897, e cila përmban katër faqe. Bëhet fjalë për shkresa të shkëmbyera ndërmjet organeve shtetërore dhe lokale, duke filluar nga shkresa e Vilajetit të Shkodrës drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe anasjelltas dhe kalimi i vendimit tek instancat që e zbatojnë vendimin. Thelbi i gjithë këtij materiali ka të bëjë me miratimin e vendimit për pagesën e pagave ish-mësuesit të shkollës fillore (mektebit) të fshatit Arbnesht, z. Idris, i cili transferohet në shkollën fillore të fshatit Ostros i Vogël, si edhe për mësues Osmanin, i cili emërohet në shkollën e Arbneshtit. Nga dokumentacioni në fjalë shohim se paga mujore e tyre ka qenë njëqind e pesëdhjetë kurush dhe se mësues Osmani, i cili u emërua në Arbnesht mësues, të jetë kompetent pasi ka arritur që t'i kryejë me sukses provimet.²¹

Shkolla fillore (sibjan mektebi) në Skje - nahija e Krajës

Në Arkivin Osman të Shtetit në Stamboll kemi identifikuar pesë dosje që bëjnë fjalë për shkollën fillore (sibjan mektebi) të fshatit Skje.²² Në këtë punim kemi paraqitur njëren dosje të datës 22 aqstos 1308 rumi/3 shtator 1892²³, në të cilën tregohet për hapjen e mektebit dhe emërimin e mësimsdhënësit të fshatit Skje, z. Omer, me pagë 110 kurush, njëherësh edhe si mësues i shkollës së re të ndërtuar në këtë fshat.²⁴

Për shkollën fillore (mektebin) të fshatit Skje si dhe mësimsdhënësin e saj Omer Fejzin prej Oblike bëhet fjalë edhe në disa shënime të një fletoreje në osmanishte të vitit 1317-1318 rumi/1901-1903, që aktualisht ndodhen në Arkivin e xhamisë të fshatit Skje. Në këtë fletore jepen edhe çmimet e mirëmbajtjes së shkollës duke siguruar drurin, dritaret, qilimat etj.²⁵

Edhe inspektori i arsimit, Daut Boriçi, në ditarin e tij, datë 16 eylül 1290 rumi/28 shtator 1874, jep listën e disa shkollave fillore që përfituan

²⁰ *Salname-i Nezaret Maarif-i Umumiye*, Daru'l-Hilafeti'l-Aliyye (Istanbul), sene 1317, ff. 924-925, sene 1318, ff. 1026-1027

²¹ BOA, *MF.MKT*, 361/33. Shih faksimilen nr. 1

²² Nga këto pesë dosje katër prej tyre janë të kategorizuara në fondin MF.MKT, 149/9, 578/30, 864/55, 149/77, si dhe një tjetër në fondin MF.IBT, 30/82

²³ Edhe vjetarët e Ministrisë së Arsimit si vit ndërtimi japin vitin 1308/1892. Shih *Salname-i Nezaret Maarif-i Umumiye*, Daru'l-Hilafeti'l-Aliyye (Istanbul), sene 1317, ff. 924-925, sene 1318, ff. 1026-1027

²⁴ BOA, *MF.MKT*, 149/9. Shih faksimilen nr. 2

²⁵ Aktualisht ky arkiv ruhet në shtëpinë e myteveliut të xhamisë të fshatit Skje, Bahri Lubani. Gjatë hulumtimeve tona të bëra kemi identifikuar 219 faqe dokumentesh me interes, prej të cilave në osmanishte 195, ndërsa në shqipe dhe në malazeze 21

disa mësimdhënës, në të cilën përmend shkollën e përbashkët për fshatrat Skje dhe Zogaj, por nuk e saktëson se në cilin prej këtyre dy fshatrave ka qenë ndërtesa. Por nga një dokument i Arkivit Osman i datës 2 agustos 1306 rumi/14 gusht 1890 shohim ekzistencën e shkollës në fshatin Zogaj²⁶, që do të thotë se në fillim shkolla e përbashkët e tyre ka qenë në Zogaj e më pas në vitin 1892 në fshatin Skje.

Shkolla fillore (ibtidai mektebi) në Ostros të Vogël - nahija e Krajës²⁷

Në lidhje me ekzistencën e shkollës fillore në fshatin Ostros i Vogël kemi gjetur tri dosje²⁸ nga Arkivi Osman. Në këtë punim kemi marrë për studim dosjen e cila bën fjalë për ndërtimin e shkollës dhe fillimin e punës së saj, si dhe një dosjeje tjetër e cila flet për emërimin e mësuesit në këtë shkollë.

Dokumenti i parë i kësaj dosjeje i përket datës 7 mayis 1312 rumi/19 maj 1896 dhe bart vulën e Valiut të Shkodrës, Abdullah Beut. Në dokument shohim se Vilajeti i Shkodrës i dërgon një shkresë Ministrisë së Arsimit, të cilën, pasi e falënderon, e njofton për ndërtimin e një shkolle/mektebi ibtidai (shkollë fillore katërvjeçare) nga ana e bashkëshortes²⁹ së Tahir Pashës dhe se këtë shkollë e frekuentonin dyzet e tre (43) nxënës, prej të cilëve njëzet e tetë (28) djem dhe pesëmbëdhjetë (15) vajza.

Për nga data, shkresa e dytë mban datën 21 mayis 1312 rumi/2 qershor 1896 dhe ka nënshkrimin e Muhjedin Beut dhe vulën e drejtorisë të shkollave (mektebi iptidai) - Ministrisë së Arsimit, dërguar zyrës së sekretarisë. Në këtë shkresë njoftohet se dokumentacioni rreth punës së shkollës i kalon sekretariatit në fjalë. Kurse shkresa e fundit në këtë dosje i përket datës 7 haziran 1312/19 qershor 1896 dhe është përpiluar nga zyra e sekretarisë në adresë të Fletores Zyrtare për t'u publikuar vendimi.³⁰ Kurse në një dosje tjetër të këtij arkivi, datë 7 temmuz 1313/19 korrik

²⁶ BOA, MF.MKT, 121/71

²⁷ Edhe vjetarët e Ministrisë së Arsimit si vit ndërtimi japin vitin 1312/1896. Shih *Salname-i Nezaret Maarif-i Umumiye*, Daru'l-Hilafeti'l-Aliyye (Istanbul), sene 1317, ff. 924-925, sene 1318, ff. 1026-1027

²⁸ BOA, MF.MKT, 207/1; MF.MKT, 321/39; MF.MKT, 361/33

²⁹ Në oborrin e xhamisë së Ostrosit të Vogël kemi identifikuar pllakën origjinale të saranxhës së ujit, në të cilën është shënuar se u ndërtua në vitin 1310 h/1892-1893 nga Hatixheja, e bija e Salih Marshiqit. Kurse varri i saj, me vit vdekjeje 1904, ndodhet në Varrezën e Dergjahit të Jahja Efendiut - Beshiktash/Stamboll. Shih Tuba Ruhengiz Dikbiyik, *Yahya Efendi kabristani mezar Taşları*, f. 413. Për më gjerësisht shih: Ali Bardhi, *Shkolla fillore publike (mekteb-i iptidai) në Ostros të Vogël u ndërtua nga bashkëshortja e Tabir Pashë Krajanit*, botuar në dy numra në revistën *Koha javore*, Podgoricë, 18 shkurt 2021, viti XX, numër 949, dhe 25 shkurt 2021, numër 950

³⁰ BOA, MF.MKT, 321/39. Shih faksimilen nr. 3

1897, shohim transferimin e mësimdhënësit të shkollës fillore (mektebit) të fshatit Arbnesht, z. Idris, në shkollën e fshatit Ostros i Vogël.³¹

Shkolla fillore (ibtidai mektebi) në Ostros të Madh - Nahija e Krajës

Në Arkivin Osman të Shtetit në Stamboll kemi identifikuar dy dosje që bëjnë fjalë për shkollën fillore (mektebi ibtidai) të fshatit Ostros i Madh.³² Duke qenë se të dyja dosjet janë të përafërta, kemi përzgjedhur vetëm dosjen e cila flet për kërkesën e mësuesit të shkollës të fshatit Ostros i Vogël, Ibrahim Hakiut, drejtuar kryeministrisë, datë 20, kanuni evvel 1321 /2 janar 1906, me të cilën kërkon që t'i shlyhen pagat e mbetura pa paguar. Në faqen tjetër të kësaj dosjeje është paraqitur edhe lista e pagave të disa muajve që kanë mbetur pa u paguar (1300 rumi/1884 m. – rumi 1320/1905 m.) ndaj mësuesit në fjalë.³³ Nëse i referohemi vitit dhe nëse mësuesi ka punuar nga ky vit në këtë fshat, atëherë i bie që kjo shkollë të ketë qenë e hapur në vitet 1884-1885.

Shkolla fillore (sibjan mektebi) në Bobosht - nahija e Krajës

Rreth ekzistencës së shkollës fillore të fshatit Bobosht gjatë hulumtimit tonë në Arkivin Osman nuk kemi arritur që të identifikojmë ndonjë dokument. Vetëm në ditarin e inspektorit të arsimit për Vilajetin e Shkodrës, Daut Boriçi, kemi arritur që të nxjerrim pak të dhëna rreth shkollës fillore në Bobosht. Në faqen 118 të fletores së punës, në osmanishte ka të shënuar kopjen e vendimit të Valiut të Shkodrës, bazuar në kërkesën e Inspektoratit për Arsim të Vilajetit në lidhje me ndërtimin e shkollës të fshatit Bobosht. Më pas, më 23 teshrin-i sani 1288/5 dhjetor 1872 vendimi i kalon Sekretariatit për Financa, të cilit i kërkohet të regjistrohet. Duhet hulumtuar më tej rreth kësaj shkolle në të ardhmen.³⁴

Shkolla fillore (sibjan mektebi) në Brisk - nahija e Krajës

Në Arkivin Osman të Shtetit në Stamboll kemi identifikuar vetëm një dosje që bën fjalë për shkollën e Briskut. Në dokumentin e datës 12 zilkade 1298 h./6 tetor 1881 m, tregohet për zhvendosjen e mësues Salihut nga shkolla fillore e lagjes Perash Nalt në shkollën e fshatit Brisk të Nahijes së

³¹ BOA, MF.MKT, 361/33. Për më gjerësisht shih te tema *Shkolla fillore në Arbnesht*

³² BOA, MF.MKT, 909/58 dhe MF.MKT, 912/50

³³ BOA, MF.MKT, 909/58. Shih faksimilen nr. 4

³⁴ Ali Bardhi, *Mijfettis Davut Boriçi'nin Günliügünde (1870-1877eğitim) İşkodra Vilayeti'nde Eğitim - Arsimi në Vilajetin e Shkodrës sipas ditarit të inspektorit të arsimit Daut Boriçi (1870-1877)*, (temë magistrature e pabotuar), Stamboll, 2009, f. 118

Krajës dhe pason me rritjen e pagës së mësuesit. Shlyerja e pagave për mësuesin do të bëhet nga të ardhurat e thesarit të Vakëfit.³⁵ Po kështu edhe në faqen 36 të ditarit të Daut Boriçit, datë 16 shtator 1290 rumi/28 shtator 1874, jepet lista e disa shkollave fillore ku përfituan disa mësime-dhënës. Ndër ta për rrethin e Krajës shohim ekzistencën e disa shkollave në Brisk, Skje-Zogaj, Ostros, Martiq.

Shkolla fillore (mektebi) në Muriq të Poshtëm

Nga hulumtimet tona të bëra në Arkivin Osman të Shtetit në Stamboll kemi identifikuar tri dosje³⁶ që bëjnë fjalë për shkollën e Muriqit.

Në dosjen e Arkivit, datë 10, Rexhep 1292 h./12 gusht 1875 m, kërkohet sqarim nga Vilajeti i Manastirit për mospërputhjen e emrit të mësime-dhënësit të shkollës fillore të Muriqit të Poshtëm, mësues Bajramit.³⁷

Në dokumentin tjetër të Arkivit Osman në Stamboll, datë 20 mart 1327, punimet e rregullimit të shkollës fillore në Muriq, të mbetura pa përfunduar, i kalojnë Sekretariatit për Financa për t'i përfunduar.³⁸

Kurse në një dokument të gjetur në Arkivin e xhamisë të Muriqit, datë 27 Xhumadiye l-ahar 1282/17 nëntor 1865, ndodhet vula e Këshillit të Vilajetit të Shkodrës. Në të vërtetohet ekzistenca e shkollës fillore në Muriq.³⁹ Vlen të përmendet se sipas pllakës origjinale të xhamisë së Muriqit të Poshtëm, kjo xhami është ndërtuar në vitin 1864. Ka shumë gjasa që menjëherë pas ndërtimit të xhamisë të jetë ndërtuar edhe shkolla fillore (mektebi).

Edhe nga ditari i inspektorit për Arsim të Vilajetit të Shkodrës, Daut Boriçi, shohim dokumentimin e ekzistencës të shkollës fillore (mektebit) në Muriqin e Poshtëm.

Në faqen 100 të këtij ditari shohim ekzistencën e shkollës fillore në Muriqin e Poshtëm, me mësues Ibrahim Pukën, i cili, për shkak të gabimit të bërë, nga data 4 gusht 1287 rumi/16 gusht 1971 m, shkarkohet nga kjo detyrë.

Në faqen 102 të këtij ditari shohim kërkesën e inspektorit për Arsim të Vilajetit të Shkodrës, Daut Boriçi, drejtuar Valiut të Shkodrës, datë 2 Teshrin-i evvel 1287/14 tetor 1871. Pasi çështja shqyrtohet pranë Këshi-

³⁵ BOA, *MF.MKT*, 71/22. Shih faksimilen nr. 5

³⁶ Janë dy dosje në fondin *ML.EEM*, 708/60 dhe 834/37, si dhe një në fondin *MF.IBT*, 6/125.

³⁷ BOA, *MF.IBT*, 6/125. Shih në "shtojcë" faksimilen nr. 6

³⁸ BOA, *ML.EEM*, 834/37

³⁹ Aktualisht ky arkiv ruhet në shtëpinë e myteveulit të xhamisë së vjetër të fshatit Muriq Nalt, z. Hasan Bracaj. Gjatë hulumtimeve të bëra nga unë dhe juristi Hajrullah Hajdari në vitin 2013 kemi identifikuar 87 dokumente, prej të cilave 34 janë në osmanishte, ndërsa të tjerat në gjuhën malazeze

llit për Arsim të Vilajetit për emërimin e mësuesit të ri të shkollës së Muriqit të Poshtëm, Ali Kruja, në vend të ish-mësuesit Ibrahim Puka t'i kalojë Sekretariatit për Financa të Vilajetit.

Po në këtë ditar është edhe kopja e vendimit, e datës 18 teshrin-i evvel 1287/30 tetor 1871, të nënshkruar nga guvernatori - valiu i Shkodrës, Mehmed Sadik, në drejtim të organeve vartëse për ta regjistruar atë në listën e nëpunësve dhe Sekretariatit e Financave, i cili bën fjalë për fillimin e punës të mësuesit të ri Ali Kruja si mësimsdhënës në shkollën fillore të Muriqit të Poshtëm.


Në faqen 113 të ditarit janë paraqitur përmbledhtazi kopjet e vendimit të Inspektoratit për Arsimin Fillor të Vilajetit drejtuar njëherësh edhe Këshillit të Vilajetit për emërimin e mësuesit në fjalë, si dhe përcjellja e vendimit tek organet e tjera vartëse deri te Sekretariati për Financa.

Edhe në faqen 180 të po këtij defteri shënohet se më 16 kanun-i evvel sene 1290/28 dhjetor 1874, mësimsdhënësit të shkollës së Muriqit të Poshtëm i jepen rrogat për muajin korrik dhe gusht në shumën prej 390 kurushë.


Në dokumentet që kemi marrë nuk kemi ndonjë që trajton gjuhën në të cilën është zhvilluar mësimi apo lëndët mësimore në shkollat-mektebet e trevës së Krajës. Për të hapur një shkëndijë, si shembull po japim një dosje të gjetur në këtë arkiv, datë 29 dhulhixhe 1310/14 korrik 1893, në të cilën shohim futjen e Mevludit dhe disa broshura në gjuhën shqipe me shkronja arabe në kurrikulat e shkollave fillore (mektebe) në Vilajetin e Shkodrës.⁴⁰ Kështu, rreth zbatimit të disa lëndëve dhe teksteve mësimore në gjuhën shqipe në hapësirën e vilajeteve shqiptare përpara Kongresit të Manastirit, hedh dritë edhe Arkivi Osman, por në të ardhmen duhen bërë hulumtime që kanë për subjekt studimi gjuhën shqipe dhe alfabetet e përdorura në shkolla.

⁴⁰ BOA, Y.PRK.AZJ, 24/84. Për më gjerësisht shih Ali Bardhi, *Hafiz Ali Ulqinaku në dokumentet e Arkivit Osman të Kryeministrisë në Stamboll. Simpozium shkencor me rastin e 160-vjetorit të lindjes së Hafiz Ali Rizga Ulqinakut të mbajtur më 25.04.2015*, Ulqin, 2015


Shtojcë:




Faksimile nr. 1




Faksimile nr. 2




Faksimile nr. 3



Faksimile nr. 4



Faksimile nr. 5



Faksimile nr. 6

Referenca

Arkivi Osman i Shtetit - Stamboll (BOA)

MF.MKT, 361/33; 149/9; 578/30; 864/55; 149/77; 121/71; 207/1; 321/39; 361/33; 71/22; 909/58.

ML.EEM., 708/60; 834/37.

MF.İBT, 30/82; 6/125.

Y.PRK.AZJ, 24/84.

Arkivat e xhamive të Krajës

Xhamia e fshatit Skje

Xhamia e fshatit Muriq

Salname (vjetarë)

Salname-i Nezaret Maarif-i Umumiye (Vjetar i Ministrisë së Arsimit), Daru'l-Hilafeti'l-Aliyye (Istanbul), sene-viti 1317-1318

Libra

Bardhi, Ali, *Müfettiş Davut Boriçi'nin Günlüğüünde (1870-1877 eğitim) İşkodra Vilayeti'nde Eğitim - Arsimi në Vilajetin e Shkodrës sipas ditarit të inspektorit të arsimit Daut Boriçi (1870-1877)*, (temë magjistature e pabotuar), Stamboll, 2009

Dikbiyik, Tuba Ruhengiz, *Yahya Efendi kabristanı mezar Taşları*, (temë magjistature e pabotuar), Stamboll, 2009

Muja, Hajrudin S, *Kraja (monografi)*, Art Club, Ulqin, 2018

Artikuj

Bardhi, Ali, *Shkolla fillore publike (mekteb-i iptidai) në Ostros të Vogël u ndërtua nga bashkëshortja e Tahir Pashë Krajanit*, botuar në dy numra në rev. *Koha javore*, Podgoricë, 18 shkurt 2021, viti XX, numër 949, dhe 25 shkurt 2021, numër 950

Bardhi, Ali, *Hafiz Ali Ulqinaku në dokumentet e Arkivit Osman të Kryeministrisë në Stamboll. Simpoziumi shkencor me rastin e 160-vjetorit të lindjes së Hafiz Ali Riza Ulqinakut*, mbajtur më 25.04.2015, Ulqin, 2015

